



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 tetor 2019

Nr.re.:RK 1459/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI96/19

Parashtrues

Đeljalj Kazagić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, PZD. nr. 820/2019, të 5 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Đeljalj Kazagić (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Mitrovicë, i cili aktualisht ndodhet në vuajtje të dënimit me burg.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PZD.nr.820/2019 të 5 shkurtit 2019 (në tekstin e mëtejme: aktvendimi i kontestuar), i cili i është dorëzuar atij më 5 shtator 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
7. Më 5 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kësaj kërkesë ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.
8. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës për herë të katërt parashtron kërkesë në Gjykatë.

Faktet në lidhje me kërkesën e parë, KI82/16

10. Më 24 maj 2016, parashtruesi i kërkesës e parashtroi në Gjykatë kërkesën KI82/16, me të cilën kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme, Pml.nr.13/2016, të 13 nëntorit 2016, me të cilin pretendonte se i ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose

Poshtërues në rastet Penale], 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në raste penale] të Kushtetutës.

11. Më vendimet e gjykatave të rregullta, të cilat i kontestonte, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me dënim unik, në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgimi.
12. Më 1 mars 2017, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, me të cilin kërkesa e parashtruesit u deklarua qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, për shkak se i njëjti nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Faktet përkitazi me kërkesën e dytë, KI50/18

13. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën KI50/2018, me të cilën kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 110/2017, të 13 nëntorit 2017, duke pretenduar se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për rishikim të procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 30 [Të drejtat e të akuzuarit], paragrafin 3 të Kushtetutës, *“për shkak të mohimit të së drejtës për të siguruar mbrojtjen e tij dhe mundësisë për t’i kundërshtuar deklaratat e dëshmitarëve dhe provat në ngarkim të tij”*, si dhe shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë], paragrafët 1 dhe 2 të Kushtetutës, me pretendimin se *“atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e Dhomës së Gjykatës së Apelit”*.
14. Më 16 janar 2019, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri, pasi konstatoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, duke qenë se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, nuk zbatohen në të tilla raste.

Faktet përkitazi me kërkesën e tretë, KI186/18

15. Më 30 mars 2018, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI186/2018, me të cilën kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 168/201, të 3 gushtit 2018, me pretendimin se gjykatat e rregullta, duke refuzuar kërkesat e tij për rishikim të procedurës penale, kanë bërë shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë] të Kushtetutës, për shkak se atij iu pamundësua pjesëmarrja në seancën e shqyrtimit të Gjykatës së Apelit.
16. Më 8 maj 2019, pasi vlerësoi rrethanat e rastit, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, dhe konkludoi se neni 6 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti penal. Për këtë arsye, Gjykata konsideroi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale, si të tilla, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës është e papranueshme.

Faktet përkitazi me kërkesën e tanishme, KI96/19

17. Më 12 shkurt 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktgjykimin P.nr. 42/14, parashtruesin e kërkesës e kishte shpallur fajtor për kryerjen e disa veprave penale dhe e kishte dënuar atë me burgim unik në kohëzgjatje prej 14 (katërmëdhjetë) vjetësh.
18. Më 7 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e apeloj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, P.nr. 42/14 të 12 shkurtit 2015, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi masën e dënimit.
19. Më 7 shtator 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin PAKR. nr. 220/15, e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me vendimin për dënimin, duke e ndryshuar masën e dënimit me burgim nga 14 (katërmëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burg. Në pjesët tjera Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë mbeti i pandryshuar.
20. Më 27 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimeve të mësipërme, ushtroi kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në Gjykatën Supreme, duke pretenduar në rrethana lehtësuese të cilat nuk u konsideruan nga gjykatat e rregullta përgjatë shqyrtimit kryesor.
21. Më 5 shkurt 2019, Gjykata Supreme me Aktvendimin Pzd.nr.8/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, me arsyetimin se i njëjti e kishte ushtruar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit pa ndonjë propozim konkret dhe se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës në fjalë konform dispozitës së nenit 431 par. 6 të KPPK.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktvendimin e kontestuar, shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, për shkak se nuk i mori parasysh faktet dhe rrethanat lehtësuese për zbutje të dënimit.
23. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Gjykata Supreme e Kosovës, me vendimin e saj Pzd.nr.8/2019 të datës 05.02.2019..., në mënyrë shumë të vrazhdët dhe jonjerëzore, të pashembullt dhe më brutale i ka shkelur “Të drejtat njerëzore dhe liritë” e mia të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës...”*
24. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se, *“Siç shihet në Vendimin e Gjykatës Supreme, nuk është respektuar asnjë rrethanë e vetme me arsyetimin se në Kërkesë nuk janë përshkruar- theksuar rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën kur aktgjykimi është sjellë apo për të cilat gjykata nuk ka pasur dijeni, ndërsa e len jashtë pjesën kruciale të dispozitës ligjore edhe pse kanë ekzistuar, të cilat do të sillnin deri tek dënimi më i butë, dhe kështu e refuzon të tërë kërkesën si të pabazë.”*

25. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që, “1. Të anulohet Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd. nr. 8/2019 të datës 05.02.2019 me të cilin është refuzuar kërkesa e ime për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe që i njëjti t’i kthehet Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim të serishëm dhe rivendosje për shkak të shkeljeve të përshkruara në detaje të dispozitave kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut për “Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm”, apo: 2. Të ndryshohet Aktgjykimin e prerë të Gjykatës së Apelit: PAKR nr.230/15 të datës 07.09.2015 me të cilin jam shpallur fajtor për katër(4) vepra penale, ashtu që së paku në mënyrë simbolike dënimin e shqiptuar, në bazë të rrethanave të paraqitura në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, unik prej 11 viteve burgim ta zvogëloj së paku për një(1) vjet, në lidhje me cilëndo vepër penale, dhe të shqiptoj dënimin e ri unik për të katër veprat penale për të cilat jam shpallur fajtor, në zgjatje të përgjithshme prej dhjetë(10) viteve burgim. [...]”

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1.Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]

28. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion; e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe të drejtat kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë.
30. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullore dhe për rastin konkret i referohet nënregullit (3) (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...].”

31. Gjykata, në këtë rast, nuk do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat ishin objekt i vlerësimit nga Gjykata në vendimet KI82/16, KI50/18 dhe KI86/18. Gjykata në rastin konkret do të vlerësojë kushtetutshmërinë e Aktvendimit të kontestuar Pzd.nr.8/2019 të Gjykatës Supreme, të 5 shkurti 2019, më të cilin kjo e fundit vendosi lidhur me kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.
32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet dhe pretendon se Aktvendimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me neni 6 të Konventës, për arsye se Gjykata Supreme nuk i mori parasysh rrethanat lehtësuese, sipas të cilave parashtruesit do i mundësohej zbutja e dënimit.
33. Në këtë kontekst, Gjykata verën se përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës “për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit” Gjykata Supreme vlerësoi vetëm aspektet procedurale, përkatësisht lejueshmërinë e kërkesës, pa e prekur substancën e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 220/15 të 7 shtatorit 2015, me të cilin parashtruesit i ishte ulur masa e dënimit nga 14 (katërmbëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burg.

34. Gjykata, para se të shqyrtojë kërkesën konkrete, rikujton se, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
35. Në këtë kuptim, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rikujton se neni 6 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, nëse një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është “akuzuar për ndonjë vepër penale” brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë*, ankesa nr. 27569/02, vendimi, i 6 majit 2003).
36. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ushtruar në Gjykatën Supreme, në fakt kërkon rihapjen e procedurave të përfunduara me vendim të plotfuqishëm, sa i përket vendimit për dënimin. Megjithatë, siç mund të vërehet nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës Supreme, kjo e fundit refuzoi si të pabazuar kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, pasi erdhi në përfundim se e njëjta nuk i përmbushte kushtet ligjore, për rihapjen ose ndryshimin e vendimit të fuqisë së prerë, sa i përket vendimit për dënimin.
37. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në të gjitha rastet kur nëpërmjet mjeteve të jashtëzakonshme është kërkuar rishikimi ose përsëritja e procedurave të përfunduara (civile, penale, përmbartimore) me vendime të plotfuqishme, kur gjykatat e rregullta janë marrë vetëm me kriteret e lejueshmërisë së kërkesave e jo me meritat e çështjes, Gjykata, në pajtueshmëri me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka konstatuar se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk është i zbatueshëm (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, KI80/15, KI81/15 dhe KI82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 dhjetorit 2016, dhe KIO7/17, *Pashk Mirashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017).
38. Prandaj, edhe kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, sikurse kërkesat për rishikim dhe përsëritje të procedurave të përfunduara, bie në kategorinë e kërkesave që janë të papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, për shkak të pazbatueshmërisë së nenit 31 të Kushtetutës, kur ky i fundit interpretohet në dritën e nenit 6 të Konventës.
39. Për më tepër, mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e “të drejtave dhe obligimeve civile” apo bazueshmërinë e “çfarëdo akuze penale”, dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, inter alia, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, *D. R. 14*, f. 171, *Zawadzki kundër Polonisë*, vendimi numër 34158/96 i 6 korrikut 1999, *Hurter kundër Zvicrës*, vendimi numër 4811/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë*, vendimi numër 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).

40. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkesë me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. Të drejtat, në të cilat thirret parashtuesi i kërkesës, duhet të mbrohen me Kushtetutë në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KIO7/17, me parashtues *Pashk Mirashi*, Aktvendimi për papranueshmëri i 29 majit 2017, paragrafi 66).
41. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe siç parashihen me Ligj dhe me Rregullore të punës.
42. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtuesit të kërkesës nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, andaj si e tillë, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (3) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 tetor 2019, njëzëri


VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi.